R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1824/6 prot. Tiranë, më 14.08.2026

V E N D I M

Nr. 32, datë 14.08.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 1824 prot., datë 01.07.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Banka e Shqipërisë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 11.06.2026, depozituar në adresën elektronike *fcela@bankofalbania.org*, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

1- *Rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 108, datë 24.12.2003*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 1824 prot., datë 01.07.2026, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 1824/1 prot., datë 06.07.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 10.07.2026.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 6270/1 prot., datë 10.07.2026, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1824/2 prot., datë 14.07.2026, i ka kthyer përgjigje Zyrës së Komisionerit dhe ankuesit, duke e informuar se: *"...në përgjigje të kërkesës suaj, nëpërmjet së cilës kërkoni vënien në dispozicion të rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 108, datë 24.12.2003, ju bëjmë me dije se kërkesa është shqyrtuar me vëmendje jo vetëm në raport me rregullin e përgjithshëm të aksesit në dokumentet zyrtare, por edhe duke peshuar me kujdes kufizimet ligjore të zbatueshme, parimin e proporcionalitetit, si dhe ekzistencën ose jo të një interesi publik mbizotërues. Duam të nënvizojmë se, pikërisht në funksion të kësaj transparence, një pjesë e informacionit që lidhet me këtë rregullore është vënë në dispozicion të publikut që prej datës 23.06.2021 dhe është e aksesueshme në rrugë elektronike, përfshirë elementet që pasqyrojnë logjikën e përgjithshme të organizimit të pagave dhe klasifikimin e vendeve të punës në nivel struktural. Vlerësojmë gjithashtu se e drejta e informimit, e garantuar nga ligji nr. 119/2014, ushtrohet në harmoni me të drejta të tjera themelore, ndër të cilat vend të veçante zë e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky harmonizim është sanksionuar shprehimisht edhe nga ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", që parashikon se: "E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në harmoni me të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare dhe të drejtën e informimit". Po ashtu, ligji nr. 119/2014 parashikon shprehimisht kufizime të arsyetuara në rastet kur dokumentacioni i kërkuar përmban të dhëna personale të mbrojtura ose informacion të klasifikuar... Publikimi i lartpërmendur (datë 23.06.2021) nuk është i rastësishëm, por shpreh pikërisht atë pjesë të përmbajtjes që mund të bëhet publike pa cenuar interesa të mbrojtur ligjërisht, pra metodologjinë dhe strukturën e përgjithshme, të shkëputura nga çdo tregues që do të mundësonte identifikimin e të ardhurave individuale. Kjo rrethanë ka rëndësi të drejtpërdrejtë për vlerësimin e kërkesës suaj. Ndarja që Banka e Shqipërisë ka realizuar tashmë në praktikë, midis asaj çka është publikuar dhe asaj çka mbetet e mbrojtur, pasqyron pikërisht kufirin ligjor mbi të cilin mbështetet edhe kjo përgjigje. Ajo çka nuk gjendet e aksesueshme në rrugë elektronike nuk është mbajtur konfidenciale për të kufizuar pa shkak të drejtën e informimit, por për arsye se bën pjesë në atë pjesë të përmbajtjes që, në rast publikimi, do të mund të prekte të dhënat personale të cilat klasifikohen sensitive për punonjësit. Në një institucion me numër të kufizuar pozicionesh të një lloji të caktuar, njohja e strukturës së pagës për një vend pune shpesh nënkupton, në praktikë, njohjen e të ardhurave të punonjësit që e mban atë pozicion. Në këtë kuptim, ajo çka në pamje të parë paraqitet si një akt i brendshëm rregullativ, në thelb bart të*

dhëna që lidhen drejtpërdrejt me situatën ekonomike të individëve të identifikueshëm. ...struktura e pagave e lidhur me klasifikimin e vendeve të punës mundëson, për nga vetë natyra e saj, identifikimin e të ardhurave individuale të punonjësve. ...Të dhënat ekonomiko-financiare individuale të punonjësve të bankës bien plotësisht në këtë kategori... Së fundmi, në vlerësimin tonë, transparenca institucionale sigurohet tashmë nëpërmjet raporteve vjetore, pasqyrave financiare të audituara dhe programit të transparencës, të cilët pasqyrojnë në mënyrë të agreguar shpenzimet për personelin, pa cenuar konfidencialitetin individual...".

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të *e-mail*-it të datës 22.07.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1824/4 prot., datë 23.07.2026, ka vijuar ankimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 1824/5 prot., datë 31.07.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi, z. , rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. Fabjola Çela, në cilësinë e koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, z. Enik Pogaçe dhe znj. Emi Santo, konfirmuan qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në shkresën kthim përgjigje nr. 6270/1 prot., datë 10.07.2026.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, Banka e Shqipërisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike"*.

Konstatohet se Autoriteti Publik argumenton duke parashtruar se: *"...e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në harmoni me të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare dhe të drejtën e informimit". Po ashtu, ligji nr. 119/2014 parashikon shprehimisht kufizime të arsyetuara në rastet kur dokumentacioni i kërkuar përmban të dhëna personale të mbrojtura ose informacion të klasifikuar..."*. Komisioneri vëren se ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim të plotë me parashikimet e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në nenin 5 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", në pikën 3 të tij parashikohet se: "...*E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash*...", dhe në pikën 23 të tij parashikohet: "...*Subjekt i të dhënave është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror*...".

Shkronja "a" e pikës 1 të nenit 17 të LDI-së parashikon se: *"...E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private..."*.

Në interpretim të dispozitave të sipërcituara dhe në vijim të deklarimeve të përfaqësuesve të Autoritetit Publik gjatë seancës dëgjimore, rregullorja "*Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 108, datë 24.12.2003*", nuk përmban asnjë nga elementet e parashikuara nga pika 23 e nenit 5 të ligjit nr. 124/2024, element i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të çojë në identifikimin e një subjekti të dhënash.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik, në interpretimin dhe përgjigjen e kthyer si ankuesit, ashtu edhe Zyrës së Komisionerit, ka dështuar të argumentojë se nëpërmjet cilit mekanizëm publikimi i kësaj rregulloreje do të cenonte të drejtat e subjekteve të të dhënave, kur në thelb përmbajtja e vendimit përcakton mënyrën e përllogaritjes së pagës përmes një formule që merr në konsideratë vetëm elementet përbërëse të saj, pa identifikuar subjekte të veçanta të dhënash.

Vlen të theksohet se asnjë nga elementet e lartpërmendur në formulën e përllogaritjes së pagës, realisht nuk bën të mundur identifikimin konkret të një punonjësi apo identifikimin e të ardhurave individuale.

Për sa më sipër, dhe në zbatim të parashikimeve të nenit 6, kryesisht të nenit 7 të LDI-së, i cili parashikon se: "1. *Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: ... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit,*

strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;... 3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike. 4. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni publikohet i përditësuar në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit, sipas mënyrës së përcaktuar nga Komisioneri", rregullorja e kërkuar me anë të kërkesës datë 11.06.2026 duhet të ishte publikuar në mënyrë proaktive nga ana e Autoritetit Publik.

Sqarojmë se LDI, edhe pa e shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë; dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar. Në kategorinë e parë përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti dhe rasti konkret, objekt shqyrtimi, i përket pikërisht kategorisë së parë, që përfshin ato informacione sipas nenit 7, për njohjen e të cilave kërkohet veprim proaktiv i Autoritetit Publik, detyrim të cilin ky i fundit nuk e ka përmbushur.

Kësisoj, argumenti se transparenca institucionale sigurohet tashmë nëpërmjet raporteve vjetore, pasqyrave financiare të audituara dhe programit të transparencës, të cilët pasqyrojnë në mënyrë të agreguar shpenzimet për personelin, pa cenuar konfidencialitetin individual, nuk është i mbështetur në ligj. Kërkuesi nuk është i detyruar të limitohet vetëm në informacionin e publikuar në dokumentet e sipërcituara, për sa kohë që informacioni i kërkuar prej tij duhet të ishte publikuar në mënyrë proaktive nga ana e Autoritetit Publik.

Edhe argumenti se në një institucion me numër të kufizuar pozicionesh të një lloji të caktuar, njohja e strukturës së pagës për një vend pune shpesh nënkupton, në praktikë, njohjen e të ardhurave të punonjësit që e mban atë pozicion, nuk gjen mbështetje në ligj. Kjo për shkak se vetë legjislatori ka vlerësuar dhe ka bërë balancën midis të drejtës për informim dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në momentin e hartimit dhe miratimit të parashikimeve të mësipërme në nenin 7 të LDI-së. I njëjti vlerësim dhe balancë është kryer edhe në kuadër të miratimit të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i cili në pikën 2 të nenit 44 të tij parashikon se: *"2. Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor, kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh".*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit*

të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Ky është një qëndrim i konsoliduar i Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet vendimeve nr. 21, datë 09.04.2021, nr. 54, datë 07.12.2023 etj., të aksesueshëm në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale https://idp.al/vendime-informimi/.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë, pika 3 e nenit 3 të LDI-së parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë (aplikimi nr.37374/05, datë 14.04.2009)* vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e "mbikëqyrësit shoqëror", duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. , me nr. 1824 prot., datë 01.07.2026, ndaj Autoritetit Publik "Banka e Shqipërisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit, sipas kërkesës datë 11.06.2026, konkretisht: *"1. Rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 108, datë 24.12.2003"*, brenda datës 24.08.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot, më datë 14.08.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi